

2447
686



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 441 Prot.

Tiranë, më 19-04 .2024

Lënda: Kthim përgjigje

Qendra “Res Publika”

Blv “Gjergj Fishta”, Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se INSTAT ka deklaruar zyrtarisht se rezultatet përfundimtare të Cens 2023 do të publikohen në Qershor 2024, sipas planit të publikimeve të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në planin vjetor, si dhe kalendarin e publikimeve të censit të INSTAT (Publikimi dhe Shpërndarja | Instat).

Në këtë plan, nuk përfshihen rezultate paraprake për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2023 pasi siç e kemi shpjeguar dhe publikisht, mbledhja e të dhënave të censit në vitet e tjera, përkatësisht 2001 dhe 2011, janë kryer me pyetësorë letër dhe rezultatet e tyre finale kërkonin kohë nga 1 vit deri në 1 vit e gjysmë për t'u publikuar.

Metoda e Censit 2023 është kryer me pajisje elektronike (tabletë) dhe kështu procesimi i të dhënave kryhet më shpejt, pra rezultatet përfundimtare do të publikohen në Qershor 2024, gjashtë muaj pas përfundimit të terrenit.

Për këtë arsye INSTAT, në bashkëpunim me asistencën teknike, vendosi që të mos publikojë rezultate paraprake kur në një distancë të shkurtër kohore do të shpallen ato përfundimtare.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ELSA DHULLI



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr.Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al